

# NGACMIMI SEKSUAL DHE LLOJET E TJERA TË DHUNËS ME BAZË GJINORE NË HAPËSIRAT PUBLIKE NË SHQIPËRI, 2019



500 intervista anketuese me gra dhe vajza në Shkodër dhe Korçë



Dy diskutime me fokus grupe me 16 pjesëmarrëse femra me prejardhje të ndryshme



12 vëzhgime të strukturura dhe dy inspektime të sigurisë në rrugë<sup>1</sup>

## Studimi


Dhuna me bazë gjinore ndaj grave është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe është e përhapur në mbarë botën, përfshirë Shqipërinë. Vlerësohet se 35 për qind e grave në mbarë botën gjatë jetës së tyre kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim, apo dhunë seksuale nga një jopartner<sup>2</sup>. Dhuna me bazë gjinore ndaj grave përkufizohet si dhunë që i drejtohet një gruaje, për shkak se ajo është grua, apo që prek gratë gjerësisht<sup>3</sup>. Dhuna ndaj grave përfshin dëmtimet fizike, seksuale dhe psikologjike (duke përfshirë kërcënimin, vuajtjen, shtrëngimin, heqjen e lirisë brenda familjes, ose brenda komunitetit të përgjithshëm, ngacmimin seksual, etj.). Sot spektri i gjerë i dhunës me bazë gjinore shpesh zgjerohet dhe përfshin dhunën që rrjedh nga raportet e pabarabarta të pushtetit mes burrave dhe grave.

Ky studim shqyrton **dimensionet e ndryshme të ngacmimeve seksuale dhe formave të tjera të dhunës gjinore ndaj grave dhe vajzave shqiptare në hapësirat publike urbane**, duke u përqendruar kryesisht në perceptimet e grave dhe vajzave lidhur me sigurinë dhe ndikimin që kjo çështje ka në jetën e tyre, si dhe format e dhunës që ato përjetojnë. Gjithashtu, studimi eksploron se si infrastruktura në këto bashki ndikon në sigurinë e grave dhe vajzave ashtu si dhe strategjitë që gratë dhe vajzat kanë në dispozicion për të përballuar dhunën dhe çfarë mund të bëhet për t'i bërë qytetet dhe lagjet e tyre më të sigurta.

## Gjetjet kryesore

Gjetjet e përgjithshme të këtij studimi tregojnë se **gratë dhe vajzat në hapësirat publike të Shkodrës dhe Korçës përballen me forma të shumta ngacmimi, veçanërisht verbal**. Ngacmimet fizike janë më pak të zakonshme, por janë të pranishme sipas shumicës së të anketuarve. Të dhënat e ndërthurura nga të dy bashkitë, tregojnë një pasqyrë të qartë të çështjeve më të përhapura për të gjitha zonat ku u krye studimi (figura në të djathtë).

Për më tepër, duket se mendësia e prapambetur dhe fenomeni i fajësimit të viktimës janë çështje mbizotëruese si në Shkodër dhe në Korçë. Nga të gjitha të anketuarat, 40 për qind pohojnë bindshëm ose pjesërisht se “Vajzat/gratë që ngacmohen ose abuzohen seksualisht, e provokojnë vetë.”



[1] Vëzhgimet e strukturuar janë vëzhgimet e një zone, me ndihmën e listave të kontrollit, për të vlerësuar kushtet e saj në aspekte të ndryshme. Inspektimi i sigurisë kryhen nga një grup grash dhe vajzat në një zonë të caktuar për të vlerësuar, me ndihmën e udhëzimeve dhe listat kontrolluese, atë që i bën ata të ndihen të pasigurt dhe se si mund të përmirësohet një zonë.

[2] Organizata Botërore e Shëndetësisë, Departamenti i Shëndetit Riprodhues dhe Kërkimit Shkencor, Shkolla e Higjienës dhe Mjekësisë Tropicale në Londër, Këshilli i Kërkimeve Mjekësore të Afrikës së Jugut (2013). Vlerësimet globale dhe rajonale të dhunës ndaj grave: Përhapja dhe efektet shëndetësore të dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale nga jopartneri/ët, fq.2. Për informacione individuale të çdo vendi, shihni Gratë e Botës 2015, Prirjet dhe Statistikat, Kapitulli 6, Dhuna ndaj Grave, Departamenti i Organizatës Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, 2015 dhe Baza e të Dhënave Botërore të Grave të OKB-së për Dhunën kundër Grave.

[3] Art. 3 d, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje)


Nëse ju apo dikush që njihni vuan nga ngacmimi apo dhuna seksuale, telefononi linjën kombëtare në numrin 116117, ose Policinë tek numrat 112.

Ti nuk je vetëm.



Gjetjet e përgjithshme tregojnë një situatë alarmante ku **16 për qind e 500 të anketuarave deklarojnë se kanë qenë në rrezik ose janë ekspozuar ndaj ngacmimeve seksuale dhe formave të tjera të dhunës gjatë jetës së tyre.** Më tej, gjetjet tregojnë se kultura e raportimit të dhunës është e ulët. Pas këtij fenomeni qëndrojnë arsye të ndryshme që lidhen me mungesën e informacionit se ku duhet të raportojnë dhe të kërkojnë ndihmë, (mbi 90 për qind e të anketuarave nga të dy bashkitë nuk janë në dijeni se ekziston një linjë kombëtare e ndihmës me numrin 116 117), mungesën e besimit në institucionet përgjegjëse dhe frikën ndaj etiketimit apo gjyqimit. Përkundër përpjekjeve të ndryshme të grupeve të interesit për të krijuar mekanizma dhe instrumente për raportimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, ekziston një besim i përbashkët që gratë dhe vajzat ndajnë për të mbajtur episode të dhunshme private dhe për ta pranuar dhunën, në mënyrë që ta mbajnë familjen së bashku.

*Gratë dhe vajzat që kanë përjetuar ngacmim apo dhunë seksuale nuk raportojnë sepse...*



Të dhënat krahasuese nga të tre bashkitë tregojnë se faktorët kryesorë që ndikojnë në pasigurinë në lagje janë: **a)** mungesa e patrullave policore të dukshme dhe të efektshme, **b)** grupet e burrave që qëndrojnë përgjatë rrugës/konsumojnë lëndë narkotike apo alkool, **c)** mungesa e transportit publik.

### Rekomandimet kyçe për bashkitë e Shkodrës dhe Korçës

- Fushata ndërgjegjësuere për edukimin e burrave, djemve, grave dhe vajzave në lidhje me ngacmimin dhe dhunën seksuale, për të luftuar mentalitetet e vjetëruara dhe stereotipet e dëmshme gjinore.
- Aktivitete për të inkurajuar angazhimin qytetar dhe për të treguar ndjeshmëri dhe mbështetje për viktimat ashtu si dhe aktivitete apo nisma që ofrojnë mundësi për diskutimin e temës së ngacmimit seksual në mënyrë të hapur ndërmjet grave dhe vajzave.
- Bashkitë duhet ta marrin në konsideratë këtë raport dhe gjetjet e tij për të gjitha veprimet që do të ndërmarrin për të përmirësuar kushtet e qyteteve të tyre, sidomos nëse ata do të ndërhyjnë konkretisht për të përmirësuar infrastrukturën në zonat e përzgjedhura si pjesë të këtij studimi.
- Administratorët lokalë, të cilët janë në kontakt me anëtarët e komunitetit, duhet të kenë njohuritë e duhura për mënyrën e trajtimit të shqetësimeve të grave dhe vajzave lidhur me sigurinë e tyre në hapësirat publike. Kjo mund të bëhet përmes takimeve dhe diskutimeve që bashkitë organizojnë me komunitetet gjatë planifikimit për përmirësimin e kushteve infrastrukturore të lagjeve të ndryshme, ose gjatë proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje nga komuniteti.
- Mekanizmi i referimit kundër Dhunës në Familje në të dy bashkitë duhet të adresojë me përgjigje shumë-sektoriale jo vetëm rastet e DhF-së, por edhe për forma të tjera të dhunës ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë ngacmimin seksual dhe dhunën që ndodh në hapësirat publike.
- Masat specifike si pjesë e përgjigjes shumë-sektoriale për parandalimin dhe mbrojtjen duhet të zbatohen duke përfshirë: **a)** Rritjen e frekuencës së patrullimit të policisë në zona të caktuara **b)** Mbrojtjen e të dhënave personale në rastet e raportimit të incidenteve të dhunshme **c)** Shtimin e të dhënave për dhunën seksuale si pjesë e të dhënave dhe statistikave të formave të tjera të dhunës ndaj grave dhe vajzave **d)** Përmirësimin e bashkëpunimit me OJF-të që janë ofruesit e shërbimeve, koordinimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për format e ndryshme të Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave dhe shërbimet ekzistuese.
- Bashkitë duhet të angazhohen, planifikojnë dhe buxhetojnë shërbime publike të aksesueshme, të përbalueshme dhe me ndjeshmëri gjinore, duke përfshirë ndriçimin rrugor, ndjeshmërinë policore, transportin publik, strehimin etj.